

---

HULUMTIM MBI GJENDJEN  
AKTUALE TË KULTURËS NË  
DIASPORËN E KOSOVËS

---

# *KULTURA DHE DIASPORA*

Prishtinë, Janar 2016



**FORUMI  
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura

Rrjeti i organizatave të pavarura të  
kulturës të Kosovës

[www.forumikulturor.net](http://www.forumikulturor.net)





**FORUMI  
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës  
[www.forumikulturor.net](http://www.forumikulturor.net)

Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian”

HULUMTIM MBI GJENDJEN  
AKTUALE TË KULTURËS NË  
DIASPORËN E KOSOVËS

# *KULTURA DHE DIASPORA*

**Author:** Adrian MORINA



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



# PËRMBAJTJA

1 HYRJE

2 METODOLOGJIA E PUNËS

3 GJENDJA AKTUALE

3.1 INSTITUCIONET E KOSOVËS DHE PUNA E TYRE NË DIASPORË

3.2 ARTISTËT NË DIASPORË

3.3 SHOQATAT KULTURORE NË DIASPORË

3.4 MËSIMI PLOTËSUES I GJUHËS DHE KULTURËS

3.5 QENDRAT KULTURORE TË KOSOVËS NË DIASPORË

4 REKOMANDIME

“Nganjëherë ne ndjehemi se i përkasim dy kulturave, ndërsa herëve tjera ndjehemi se po rrëzohemi në mes dy stolave”.

- **Salman Rushdie**, Imaginary Homelands: Essays and Criticism 1981-1991

“Nëse e investojmë një kunë për diasporën, diaspora do të na e kthej me një mijë”

- **Thënie kroate**

# 1. HYRJE

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë së Kosovës, i cili ishte realizuar në vitin 2011, në Kosovë jetojnë 1.739.825. Me gjithë kontestimet e ndryshme që i ka pasur ky kontestim nga palë të ndryshme, si për nga metoda e regjistrimit gjithashtu edhe për nga saktësia, është vërejtur edhe një e metë e madhe me rastin e mos regjistrimit të shtetasve të Kosovës të cilët jetojnë në diasporë.

Sipas statistikave dhe informative të ndryshme, në diasporë jetojnë një numër shumë më i madh i njerëzve që kanë lidhje të drejtpërdrejta me Kosovën sesa në vet Kosovë.

Kjo edhe për arsyeje se migrimi nga Kosova për në vendet tjera (kryesisht ato perëndimore) ka ndodhur në etapa të ndryshme historike.

Gjithashtu edhe aspekti politik i organizimit të diasporës, ku pjesëtarët e komuniteteve grumbullohen në baza etnike e jo shtetërore, e bën edhe më të vështirë informatën e saktë të pjesëtareve të diasporës së Kosovës në botë. Kjo për fak-

tin se diaspora shqiptare është e organizuar si një, pavarësisht nga shtetet e rajonit prej nga vijnë, njëjtë si edhe diaspora serbe e Kosovës e cila nuk pranon të quhet diasporë e Kosovës por e trajton vetën si diasporë serbe.

Sipas statistikave të ndryshme, vetëm në Turqi jetojnë rreth 5 milion qytetarë me prejardhje shqiptare, ku shumica e tyre janë me prejardhje nga Kosova ndërsa pjesa tjetër është kryesisht nga trevat shqiptare në Maqedoni dhe Republika e Shqipërisë.

Deri sa në Greqi dhe Itali, ku diaspora shqiptare llogaritet të jetë mbi 2 milion, ata vijnë kryesisht nga Republika e Shqipërisë, ndërkaq në Evropën Qendrore (Zvicër, Gjermani, Austri) ku llogaritet të jetojnë rreth 850.000 anëtarë të diasporës shqiptare, rreth 80% janë diasporë me lidhje të drejtpërdrejta me Kosovën.

Ndërkaq në SHBA llogaritet të jenë rreth 1 milion pjesëtarë të diasporës shqiptare.

Një prej vështirësive tjera për identifikimin e numrit të diasporës

së Kosovës është edhe fakti se në shumicën nga shtetet perëndimore, statistikat shtetërore bëhen në bazë të gjuhës së folur (p.sh. shqip-folës, serbo-folës) dhe jo në bazë të vendit të prejardhjes.

Me gjithë problematikat statistiko-re, Qeveria e Kosovës ka krijuar një bazë të mirë ligjore dhe administrative për të ruajtur lidhjet me diasporën.

Sot në Kosovë, në bazë ligjore kemi Ligjin për Diasporën dhe Mërgatën (Ligji Nr. 04/L-095), dhe Strategjinë për Diasporën 2013-2018.

Gjithashtu sot në Kosovë ekziston edhe Ministria e Diasporës, në mandatin e saj të dytë,

## *2. METODOLOGJIA E PUNËS:*

Të dhënat për këtë hulumtim janë siguruar nga takimet e drejtpërdrejta me zyrtarët e lartë të Ministrisë së Diasporës, zyrtarë të Ministrive të Kulturës, të Arsimit dhe asaj të Punëve të Jashtme, përmes intervistimit të organizatave përfituese të granteve për realizimin e aktiviteteve nga Ministria e Diasporës si dhe përmes bisedave dhe intervistave të drejtpërdrejta me pjesëtarët e diasporës, kryesisht në Evropën Qendrore.

Gjatë këtij hulumtimi, është vërejtur se: ky është hulumtimi i parë i këtij lloji i bërë ndonjëherë; prandaj edhe mundësia e bazimit në hulumtime dhe analiza paraprake ka qenë i pamundur.

Të gjitha informatat janë të grumbulluara gjatë periudhës Nëntor-Dhjetor 2015.



## 3. GJENDJA AKTUALE

### 3.1 Institucionet e Kosovës dhe puna e tyre në diasporë:

- Ministria e Diasporës e Republikës së Kosovës është ministri në mandatin e saj të dytë. Në kuadër të kësaj ministrie ekziston edhe Departamenti për Ruajtjen e Identitetit ku përfshihet edhe Divizioni për Kulturë dhe ai për Arsim. Disa nga aktivitetet kryesore në fushën e kulturës që kjo ministri i bën janë edhe:

Hapja dhe menaxhimi i Qendrave Kulturore të Kosovës në Diasporë dhe Mërgatë

Furnizimi me libra të gjuhës dhe kulturës shqipe në shkollat e organizuara në diasporë

Organizimi i Ditëve të kulturës shqiptare në botë

Organizimi i aktiviteteve përgjatë ‘Ditëve të diasporës’ gjatë sezonit të diasporës (Sezoni i verës)

Subvencionimi i projekteve të shoqatave dhe grupeve e individëve në diasporë

Rrjetëzimi i shoqatave dhe grupeve kulturore në diasporë

Identifikimi i artistëve dhe shfrytëzimi i kapaciteteve të tyre si

pjesë e programit për “Brain Gain” Promovimi i storjeve të suksesit të artistëve dhe grupeve nga diaspora në Kosovë

Promovimi dhe përkrahja e botimit të librave të shkrimtarëve nga diaspora

Furnizimi me libra i bibliotekave të ndryshme, me përkrahje edhe të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, në bazë të kërkesave të pjesëtarëve të diasporës

- Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës përpos që është pjesë e aktivitetit të “Ditët e kulturës shqiptare” nuk është e përfshirë drejtpërdrejtë në ndonjë aktivitet tjetër në diasporë. Gjithashtu është e hapur për subvencionim të projekteve nga shoqatat nga diaspora.

- Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, në koordinim me shoqatat dhe organizatat kulturore në Diasporë bën organizimin e aktiviteteve kulturore përmes Ambasadave dhe Konsullatave të Kosovës në vendet ku veprojnë, por kryesisht këto aktivitete mbesin në nivelin e festave

të ndryshme kombëtare, si Dita e pavarësisë, 8 marsi etj.

- Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës merret drejtpërdrejtë me përcaktimin e kurrikulave të librave për mësimin plotësues të Gjuhës dhe kulturës shqipe në Diasporë si dhe botimin e këtyre librave.

Gati të gjitha komunat në Kosovë, realizojnë aktivitete të vogla përgjatë sezonit veror, por që realisht janë kryesisht në nivele të takimeve ose të realizimit të ndonjë koncerti me moto “Mirë se vini bashkatdhetarë”

Në bazë të ligjit për diasporën, Televizioni publik (RTK) e ka për obligim që 9 përqind të programit të saj ta ketë të dedikuar për diasporën, por gjendja aktuale nuk i afrohet as për së afërmi tek përqindja e paraparë.

### **3.2 Artistët në diasporë**

Historikisht, roli i diasporës shqiptare dhe individëve të ndryshëm nga diaspora ka qenë shumë i madh dhe i rëndësishëm në të gjitha fushat jetësore. Kjo ka ni-

sur qysh nga Rilindja kombëtare përmes Jeronim De Radës dhe botimit të gazetës së parë shqipe e deri në ditët e sotme.

Gjendja aktuale e numrit të artistëve të suksesshëm në diasporë, pavarësisht që varion nga shteti në shtet, është jashtëzakonisht e madhe por jo edhe ‘shfrytëzimi’ i kapaciteteve të tyra nga ana e Kosovës.

Disa nga artistët aktual më të njohur shqiptarë nga diaspora janë: Ismail Kadare (Shkrimtar-Francë), Rita Ora (Pop këngëtare-Britani e Madhe), Elina Duni (Xhaz këngëtare – Zvicër), James Belushi (aktor-SHBA), Angjelin Prelocaj (Koreograf-Francë), Sisley Xhafa (Artist konteporan-SHBA), Eliza Dushku (Aktore-SHBA), Rexhep Mitrovica (Aktor – Francë), Dua Lipa (Këngëtare- Britani e Madhe), Sten Dragoti (Regjisor-SHBA), Inva Mula (Këngëtare-Francë), Shkelzen Doli (Violinist-Austri).

Gjitashtu është edhe një kategori e madhe e artistëve nga diaspora të njohur në shtetet ku jetojnë, si: Alban Ukaj (Aktor-Bosnje), Eda

Zari (Këngëtare-Gjermani), Arben Bajraktaraj (Aktor-Francë), Astrit Alihajdaraj (Aktor-Austri), Imer Kutllovci (Aktor-Francë), Ramë Lahaj (këngëtar-Gjermani), Ardian Bujupaj (Pop këngëtar-Gjermani), Përparim Rama (Arkitekt-Britani e Madhe) etj.

Këtyre emrave mund të ju shtohen edhe qindra artist tjerë, që në mënyrë profesionale merren me art, të lindur dhe të rritur në diasporë (rasti i shumë aktorëve të famshëm nga Turqia) por edhe tjerë, gjithandej botës.

Sidoqoftë, bashkëpunimi me institucionet e vendit dhe shfrytëzimi i kapaciteteve të tyre mbetet shumë i vogël. Hiq rastit të Rita Orës e cila është e emëruar nga Presidentja e Kosovës si Ambasadore nderi për promovimin e Kosovës, kapacitetet e tyre artistike janë rrallë të përdorura, përpos në raste sporadike kur ndodh ndonjë koncert apo projekt në baza private.

Mos shfrytëzimi i tyre mund të shihet edhe nga aspekti i mungesës së madhe të tregut të prodhimtarisë kulturore në Kosovë.

### **3.3 Shoqatat kulturore në diasporë**

Numri i shoqatave kulturore, sipas informatave të Ministrisë së Diasporës është shumë i madh. Shumica e këtyre shoqatave janë të organizuara në mes të viteve 90, me motivin kryesor për ta mbajtur gjallë frymën kombëtare si nevojë e kohës për ruajtjen e identitetit dhe kontributin e dhënë për çlirimin e Kosovës.

Sidoqoftë, është vetëm një numër i vogël i tyre të cilët punën në shoqata e kanë punë primare dhe punojnë në nivele profesioniste. Shumica dërmuese e shoqatave dhe grupeve në Diasporë mbetën në nivel të ultë të funksionimit si dhe aktivitetet e tyre mbeten kryesisht në kultivimin e muzikës folklorike si dhe valleve e këngëve tradicionale.

Një problem tjetër shumë i rëndësishëm është edhe mos koordinimi i tyre në mes vete, përmes krijimit të rrjeteve të shoqatave kulturore. Ministria e Diasporës është duke punuar me të gjitha shoqatat për rrjetëzimin e tyre në nivele të

shteteve, por sfidat kryesore që po i hasin janë raportet e së kaluarës në mes të shoqatave si dhe tendencat e herë pas herë të politizimit të tyre nga partitë politike në Kosovë. Këto shoqata, kryesisht mbijetojnë përmes punës vullnetare, një pjesë e tyre çdo vit aplikojnë për fonde në Institucionet e Kosovës, kryesisht në Ministrinë e Diasporës, një pjesë e tyre aplikojnë me projekte edhe në Ministrinë e kulturës, ndërsa vetëm një përqindje shumë e vogël e tyre shfrytëzojnë fondet e shteteve ku ato veprojnë, për integrim të komuniteteve. Fondet e Ministrisë së Diasporës janë të limituara. Vetëm në vitin 2015, kërkesa ka qenë mbi 2 milion euro për projekte ndërsa fondet e MeD për ti mbështetur këto aktivitete kanë qenë vetëm 130 mijë euro, të ndara për 67 projekte të ndryshme. Gjithmonë sipas informatave nga Ministria e Diasporës, vetëm në Austrinë e Epërme ndahen fonde prej rreth 30 Milion euro çdo vit për integrimin e komuniteteve, ku të drejtë kanë të aplikojnë shoqatat e emigrantëve që jetojnë në këtë

pjesë të Austrisë, por shoqatat nga komuniteti i Kosovës, megjithëse janë komuniteti i katërt për nga madhësia, janë të fundit në listën e përfituesve të këtyre fondeve. Dhe kjo ndodhë, jo për shkak të mungesës së dëshirës nga autoritetet e atjeshme për ti përkrahur, por për shkak të mungesës së kapaciteteve profesionale për të përgatitur projekte dhe për të aplikuar në këto fonde.

Numri i shoqatave të cilat merren me aktivitete kulturore, sipas regjistrimit të identifikuar nga Ministria e Diasporës, në bazë të shteteve:

ZVICËR: 132  
GJERMANI: 99  
AUSTRI: 35  
SLOVENI: 3  
KROACI: 18  
SUEDI: 27  
ANGLI: 40  
FRANCË: 6  
ITALI: 11  
NORVEGJI: 2  
SHBA: 34  
BELGJIKË: 8  
DANIMARKË: 3

FINLANDË: 4  
GREQI: 8  
AUSTRALI: 6  
KANADA: 10

### **3.4 Mësimi plotësues i gjuhës dhe kulturës**

Mësimi i gjuhës dhe kulturës shqipe në diasporë mbahet dhe zhvillohet në vende të ndryshme të botës, aty ku më së shumti janë të koncentruar diaspora shqiptare.

Më poshtë po ju njoftojmë me disa shtete në të cilat zhvillohet mësimi i gjuhës dhe kulturës shqipe. Për të analizuar këtë gjendje kemi marrë një analizë të gjendjes aktuale në Gjermani, se si zhvillohet ky proces:

Gjurmët e para të shkollës shqipe i gjejmë në landin e NRË, në qytetin Ojskirshen, afër Këlnit, në shkollën fillore (Grundschule) Paul Gerhard. Mësimi shqip filloi me 21 prill të vitit 1975. Pas pak kohe u hapën shkollat edhe në qytetet Kuhenhajm, kall, shtolcajm dhe Shtollberg, qytete këto të vogla në afërsi të qytetit universitar të Ahenit. Mësuesi që zhvilloi mësimin në këto

qytete ishte Faik Mehmeti, i emëruar nga organet e Krahinës Autonome të Kosovës.

Viti shkollor 1989/90 solli ndryshime në organizimin e mësimi shqip. Disa mësues vendosën të ftojnë kolegët e tyre për të biseduar rreth çështjes së vetorganizimit të mësimi plotësues. Në takim u vendos që për datën 14.09.1990 të thirrej një kuvend pune me qëllim të themelimit të një këshilli të mësuesve shqiptar. Kuvendi u mbajt më 14.09.1990 dhe nga ky kuvend u themelua shoqata e arsimtarëve shqiptarë, e cila do të quhej Këshilli i Arsimtarëve Shqiptarë "Naim Frashëri" në Gjermani.

KASH-i me punën e tij zgjeroi rrjetin e shkollave shqipe si dhe vuri bashkëpunim me organet legjitime të Republikës së Kosovës.

Mësimi plotësues në gjuhën shqipe në Gjermani është në gjendje jo të mirë me përjashtim të qyteteve Hanover, Osnabruck, Dyseldorf, Frankfurt, Hamburg, Volksburg. Në këto qytete përkatësisht lande, punojnë rreth 40 mësues të cilët paguhën nga shteti gjerman, por

shumica e tyre pos mësimit të gjuhës shqipe, mbajnë mësim edhe në gjuhën gjermane. Ndërkaq, mësimi është i organizuar relativisht mirë edhe në Badenvurtemberg. Në qytetet e këtij landi si Shtutgard, Fraiburg e qytete tjera më të vogla, punojnë aktualisht 28 mësues me më pak se 1000 nxënës dhe atë në bazë vullnetar. Punohet në shkollat gjermane pas orarit të rregullt dhe të shtunave. Në disa qytete të mëdha si Karlsruhe, Singen, Helbrone etj. shkollat kanë ndërprerë mësimi para 5 viteve pavarësisht se kanë mësues dhe numër të madh të nxënësve shkaku i mos pagesës së mësuesve.

Në Bavari gjendja është edhe më e keqe. Punojnë vetëm 3-4 mësues jashtë objekteve shkollore ndërsa shkolla e Memingenit me rreth 100 nxënës rrezikohet të mbyllet si shkak i mungesës së lokalit. Në landet Bavari dhe Badenvynterberg, sipas të dhënave të përafërta, jetojnë rreth 2000 mijë shqiptarë. Numri i fëmijëve të moshë shkollore vlerësohet të jetë më i madh se 200 mijë kurse në mësim plotë-

sues marrin pjesë më pak se 20 mijë. Në Berlin punon vetëm 1 mësuese me rreth 50 nxënës dhe atë në bazë vullnetare. Mësimi mbahet në shkollën gjermane. Në landin e Berlinit jetojnë rreth 20 mijë shqiptarë. Në pjesë tjera të Gjermanisë pos këtyre që u përmendën, nuk mbahet fare mësimi në gjuhën shqipe.

Numri i shkollave (klasave), mësuesve dhe nxënësve (për shtetet që janë të ndara në kantone, republika apo në forma të tjera, shënohen informatat sipas ndarjes)

Numri i mësuesve aktiv të mësimit shqip në Gjermani është rreth 70 ndërsa numri i nxënësve që ndjekin mësim plotësues është rreth 2000. Po vazhdojmë më analizën e gjendjes së mësimit të gjuhës dhe kulturës shqipe në Zvicër: Lidhja e Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë “N. Frashëri” në Zvicër ka filluar aktivitetin e saj më 20 shtator 1990 me organizimin e mësimit plotësues në gjuhën shqipe. Fillimisht kanë qenë dy shoqata:

Shoqata e Prindërve Shqiptarë dhe Shoqata e Arsimitarëve Shqiptarë të cilat janë shkruar në një shoqatë të vetme të quajtur LAPSH (Lëvizja e Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë) në vitin 1995 dhe po këtë vit është pranuar në mënyrë ligjore nga organet kompetente të Zvicrës. LAPSH ka kryesinë e saj e cila përbëhet nga kryetarët e Këshillave Kantonal, kryetarin e kryesisë, sekretarin dhe arkëtarin.

Nëpër ato vende ku mbahet mësimi plotësues formohen Këshillat e Prindërve. Gjatë viteve '90 mësimin e kanë ndjekur më shumë nxënës se sa në dekadën e parë të vitit 2000 e tash. Shkaqet janë të ndryshme.

Sistemi i organizimit të mësimin të gjuhës shqipe (përfshirë sistemin e menaxhimit dhe organizimit

Mësimi mbahet në kohën kur nxënësit janë të lirë, pra jashtë orarit të rregullt mësimor zakonisht pasditeve. Mësimi është me vete dëshire, pra prindërit nuk janë të obliguar që t'i dërgojnë patjetër

fëmijët në shkollë.

Pala zvicerane i ofron klasat dhe mjetet mësimore në shfrytëzim. Mësimi mbahet dy orë në javë. Në mbi 90% të vendeve ku mbahet mësimi, mësuesit paguhen nga ana e prindërve.

Numri i shkollave (klasave), mësuesve dhe nxënësve (për shtetet që janë të ndara në kantone, republika apo në forma të tjera, shënohen informatat sipas ndarjes)

Numri i klasave në 14 kantonet e Zvicrës ku mbahet mësimi plotësues është 1809 nxënës, 160 klasa, 57 mësimdhënës dhe rreth 14 përgjegjës kantonal.

Për më shumë informata shihni tabelën e mëposhtme:

<b>Kantoni</b>	<b>Numri i mësimdhënësve</b>	<b>Numri i klasave</b>	<b>Numri i nxënësve</b>
Aargau	6	10	250
Basel Stadt und Basel Land	1	2 + (1)	20
Bern	7	8	162
Glarus	1	2	43
Geneve	6	19	285
Jura	1	6	87
Neuchâtel	1	1	18
Schaffhausen	1	1	7
Schëyz	1	1	15
Solothurn	1	2	16
St. Gallen	6	26	198
Thurgau	7	10	93
Vaud	10	14	118
Zürich	8	40	497
14	57	160	1809



## Austri:

- Në shkollat publike austriake, përveç mësimin të rregullt në gjuhën gjermane, organizohet edhe mësimi plotësues në gjuhën shqipe. Mësimi organizohet, financohet dhe kontrollon nga institucionet përkatëse të arsimit në Austri dhe atë:
  - Në shkollën që frekuenton nxënësi në orarin e paradites nëse është numri i mjaftueshëm i nxënësve (së paku 12 nxënës).
  - Grumbullimi i nxënësve nga disa shkolla në shkollën më të afërt.
  - Numri i orëve mund të jetë nga 2 deri në 6 orë mësimi në javë.
  - Prindërit duhet të plotësojnë një formular me të dhënat për nxënësin dhe shprehen që fëmija i tyre të vijojë rregullisht mësimin plotësues.
  - Formulari merret në shkollën ku fëmija është i regjistruar.
  - Mësimi plotësues shqip

mbahet sipas plan programeve nga Ministritë e Arsimit të Kosovës e Shqipërisë.

- Lëndët që mësohen janë: gjuhë e letërsi shqipe, histori, gjeografi, edukatë muzikore, art figurativ. Të gjitha këto me bazë nga të gjitha trevat shqiptare.
- Shumë nga tekstet shkollore sigurohen falas nga Ministria e Arsimit e Austrisë dhe Ministria e Arsimit e Kosovës.

Numri i shkollave (klasave), mësuesve dhe nxënësve (për shtetet që janë të ndara në kantone, republika apo në forma të tjera, shënohen informatat sipas ndarjes)

Në Austri nga 12,500 nxënës shqiptarë vetëm 2, 5 mijë ndjekin mësimin në gjuhën shqipe, ndërsa numri i mësuesve aktiv thuhet të jetë 19.

Këto janë vetëm disa shtete të cilat i kemi paraqitur analizat e gjendjes aktuale të mësimin të gjuhës dhe kulturës shqipe në diasporë.

### 3.5 Qendrat Kulturore të Kosovës në Diasporë

Qeveria e Kosovës, me datë 25.10.2013, ka marrë vendimin nr. 05/153 për themelimin e Qendrave Kulturore të Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën në këto shtete: Zvicër, Gjermani, Francë, Austri, Suedi dhe SHBA, si dhe me datë 30.01.2013 ka marrë vendimin me nr. 08/2014 për hapjen e qendrës Kulturore të Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën në Turqi, të cilat funksionojnë në bazë të ligjit 04/L-095 për diasporën dhe mërgatën. Qendrat në Zvicër, Turqi dhe Suedi tashmë janë hapur ndërsa gjatë periudhës 2016–2018 Ministria e Diasporës ka për detyrë të udhëheqë të gjitha procedurat për themelimin dhe funksionalizimin e Qendrave në Gjermani, Francë, Austri dhe SHBA. Pavarësisht vendimit të marrë nga Qeveria për hapjen e këtyre qendrave, ana financiare nuk është ndarë asnjëherë për hapjen dhe mirëmbajtjen e tyre. Gjithashtu edhe baza ligjore është shumë problematike, sepse të njëjtat nuk

janë paramenduar mirë paraprakisht se si do të funksionojnë edhe për shkak të mundësisë së thithjes së fondeve në vendet ku operojnë. Qendra Kulturore e Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën (QKKDM) në Turqi si qendër e parë është hapur më 23.02.2013, ndërsa me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 25.10.2013 është paraparë të themelohen edhe qendra të tilla në, Gjermani, Francë, Austri dhe SHBA. Krahas QKKDM-ve në Turqi dhe Zvicër në mars të vitit 2014 është hapur QKKDM në Suedi.

Misioni i Qeverisë së Kosovës me hapjen e këtyre Qendrave kulturore, është ruajtja e identitetit kombëtar dhe promovimi i kulturës sonë në vendet ku Diaspora jeten dhe vepron. Në këtë mënyrë, pjesëtarët e diasporës përveç që krijojnë lidhje me atdheun, i forcojnë lidhjet e shtetit tonë me vendin pritës. Ministria e Diasporës, për realizimin e këtij misioni, përmes Qendrave Kulturore, bën organizimin e një sërë aktiviteteve kulturore, gjithnjë duke iu përshtatur edhe kërkesave

të pjesëtarëve të diasporës. Këto aktivitete përfshijnë mbajtjen e kurseve të gjuhës shqipe, organizimin e koncerteve në bashkëpunim me shoqatat kulturore aktive në shtetet ku Qendrat janë themeluar, organizimin e paneleve të ndryshme letrare, promovimin e librave, ekspozita artistike etj, si dhe ato janë të hapura për aktivitetet dhe organizimet e vetë pjesëtarëve të diasporës.

Në mënyrë të arritjes së rezultateve sa më të mira, gjatë mbledhjes së përbashkët të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të datës 23 mars 2015 në Tiranë, ndër të tjera është nënshkruar edhe Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Diasporës, Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë, për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta kulturore në diasporë si dhe hapjen e Qendrave të përbashkëta kulturore në Diasporë. Deri më tani nuk është nisur asnjë procedurë për hapjen e këtyre

qendrave të përbashkëta.

# REKOMANDIME

Të krijohet infrastruktura ligjore për strukturën dhe funksionalitetin e Qendrave Kulturore

Të ndahen mjetet financiare nga Qeveria e Kosovës për themelimin e menjëhershëm të Qendrave Kulturore në vendet e parapara me vendimet e marra.

Fondet e ndara për punë aktivitete kulturore në dhe me diasporën të ngritën në nivelin e nevojave dhe kërkesave.

Të krijohen mekanizma për ngritjen e kapaciteteve profesionale të organizatave kulturore në Diasporë nga institucionet e Kosovës

Të krijohet një bazë e të dhënave më e saktë e të gjitha organizatave dhe individëve që mirën me aktivitete kulturore në Diasporë.

Të realizohen në tërësi marrëveshjet me Republikën e Shqipërisë për hapjen e Qendrave Kulturore, aktiviteteve të përbashkëta kulturore si dhe për organizimin e mësimin të gjuhës dhe kulturës në Diasporë.

Involvimi i Ministrisë së Kulturës dhe asaj të Punëve të jashtme në përkrahje më të madhe të Ministrisë së Diasporës është i detyrueshëm

sidomos në projektin e “Ditëve të kulturës”

Radio Televizioni i Kosovës të zbattoj obligimet që vijnë nga Ligji për Diasporën për përqindjen e dedikuar të programacionit për diasporën.

# Forumi Kulturor

Teatri Oda organizoi një mori takimesh informative gjatë fundvitit 2011 me qëllim të krijimit të një rrjeti të përbashkët të organizatave të kulturës në Kosovë. Në këto takime morën pjesë më se 60 pjesëmarrës, përfaqësues nga organizata të ndryshme të kulturore dhe kështu u krijua mundësia e organizimit të Kuvendit themelues, i cili u mbajt me 23.03.2012 dhe vuri themelet e Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës – Forumi Kulturor. Kuvendi Themelues vuri themelet e Forumit Kulturor duke anëtarësuar 22 organizata të pavarura në kuadër të Rrjetit. Përmes votave demokratike u aprovua statuti, njëkohësisht u zgjodh edhe Kryesia e rrjetit. Forumi Kulturor është etnitet i regjistruar si rrjet i organizatave të pavarura kulturore si anëtare. Si Sekretariat i përkohshëm i Forumit Kulturor është vendosur të jetë Teatri ODA deri në momentin e ngritjes së kapaciteteve për të formuar një Sekretariat profesional të rrjetit.

**Forumi Kulturor i Kosovës është Rrjeti i Organizatave të Pavarura të Kulturës të Kosovës themeluar me qëllim të:**

- Fuqizimit të organizatave të pavarura kulturore, duke i zhvilluar kapacitetet e

tyre për realizimin e programeve të tyre,

- Afirmimit të organizatave anëtare,
- Përfshirjes së organizatave anëtare në proceset vendimmarrëse,
- Rritjes së përkrahjes së skenës së pavarur të kulturës,
- Mbrojtjes dhe përmirësimit të pozitës së organizatave anëtare karshi institucioneve relevante të Kosovës dhe jashtë saj.

**Forumi Kulturor synon të përmbushë misionin e vet nëpërmjet aktiviteteve si:**

- Komunikimi dhe rrjetëzimi i organizatave të pavarura në fushën e kulturës
- Shkëmbimi dinamik i informacioneve dhe përvojave
- Aktivitetet e lobimit dhe avokimit
- Trajnimet specifike për nevojat e organizatave anëtare
- Organizimi i debateve dhe forumeve
- Bashkërenditja e aktiviteteve artistike dhe kulturore

# Forumi për Zhvillim Kulturor

Forumi për Zhvillim Kulturor është projekt që ka për qëllim të zhvillojë më tutje dhe të forcojë Forumin Kulturor të themeluar në vitin 2012, duke ofruar këshilla dhe njohuri të vlefshme për politikatat kulturore të Kosovës. Projekti është i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë, e bartës të projektit janë Forumi Kulturor, Teatri ODA dhe Do-kuFest. Projekti ka filluar me aktivitetet e para në dhjetor të vitit 2013, ndërsa parashihet të zgjasë deri në nëntor të vitit 2015. Në një periudhë dy vjeçare, Forumi për Zhvillim Kulturor do të prodhojë të paktën 28 produkte të politikave të kulturës, të cilat do të rezultojnë nga hulumtime, debate, fokus grupe dhe konferenca. Projekti do të forcojë rrjetin e komunitetit të kulturës së pavarur, të ndërtojë kapacitetet e saj të brendshme dhe të ndikojë në hartimin e politikave kulturore të Kosovës përmes prodhimit të dijes për kulturë. Po ashtu, projekti do të nxisë dialogun dhe bashkëpunimin mes sektorit të kulturës së pavarur dhe autoriteteve publike në mënyrë që të dalë me zgjidhje konkrete për zhvillimin kulturor në Kosovë.



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë



Implementuar nga:



FORUMI  
KULTUROR

Projekti i organizuarave të pavarur të kulturës në Kosovë

DO  
KUFEST  
International Documentary  
and Short Film Festival

TEATRI  
ODA

The background features a complex geometric pattern of overlapping squares and lines. The squares are rotated 45 degrees, creating a diamond-like appearance. The lines are thin and light blue, forming a grid that intersects with the squares. The overall effect is a modern, minimalist design.

*forumikulturor.net*  
*facebook.com/ForumiKulturor*  
*twitter.com/forumikulturor*



*forumikulturor.net*  
*facebook.com/ForumiKulturor*  
*twitter.com/forumikulturor*